

PROCESVERBAL
nga seanca e parë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 14.1.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska dhe Petar Xhurovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Viktor Pavlovski (në pushim vjetor).

Mungon: dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (në pushim vjetor).

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef kabineti, mr. Dragica Ljubevska, zëvendësoi drejtorin e Agjencisë në bazë të autorizimit me nr. 03-5648/1 datë 29.12.2025.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, mr. Gorjan Sheqerinov, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e parë të Këshillit. Seanca filloi në orën 13:40 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Njëkohësisht, ju uroi të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe të punësuarve në shërbimin profesional Gëzuar Vitin e Ri 2026, duke ju dëshiruar punë të suksesshme dhe produktive.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 26-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 26.12.2025.
2. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë.
3. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë së SHTR "Radio VAT" SHPK Shkup.
4. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR "Modea" SHPKNJP Sveti Nikollë për shkelje të nenit 53, paragrafët 4 dhe 5, dhe në lidhje me nenin 53, paragrafët 6 dhe 19 të LShMAAV.

5. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj SHTR "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë për shkelje të nenit 51, paragrafi 1 të LShMAAV.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 26-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 26.12.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – shef kabineti, mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi Propozim-vendimin për vazhdimin e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë. Ajo shpjegoi se transmetuesi posedon leje për radiotransmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, për shërbim programor – radio folëse muzikore me format informativ kryesisht të përgjithshëm, në gjuhën shqipe. Vlefshmëria e lejes është nëntë vjet, përkatësisht deri më 16 janar 2026. Më 9 janar, transmetuesi ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e lejes për radiotransmetim, në formular përkatës të publikuar në ueb-faqen e Agjencisë. Pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur, u konstatua se kërkesa ishte e rregullt dhe e plotë dhe përmbante të gjitha shtojcat e përcaktuara. Ndër shtojcat e paraqitura janë: deklaratë e noterizuar nga drejtuesi ku transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie - ndalesë për kryerjen e veprimtarisë; deklaratë nga themeluesi dhe drejtuesi i vetëm se "Radio Jehona" do të përmbushë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike dhe rregulloret e miratuara në bazë të Ligjit për Komunikimet Elektronike, se do të përmbushë kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në përputhje me rregulloren përkatëse të Agjencisë; se nuk shkel dispozitat e Kapitullit IV të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele; si dhe deklaratë se të dhënat e cekura në kërkesë janë të sakta, dhe shtojcat e paraqitura janë të besueshme dhe të vlefshme. Agjencia konstatoi se aplikanti "Radio Jehona" i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në Ligj dhe se gjatë vlefshmërisë së lejes nuk ka kryer ndonjë shkelje serioze. Shkelje serioze, të cilat përbëjnë bazë për refuzimin e kërkesës, konsiderohen: mosrespektimi i ndalesave të veçanta sipas nenit 48 të Ligjit, së paku tre herë gjatë vlefshmërisë së lejes, për të cilat ka aktvendim gjyqësor të formës së prerë, ose nëse gjatë së paku një cikli zgjedhor të mbulimit mediatik nuk është realizuar në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, për të cilat gjithashtu ka vendim gjyqësor të formës së prerë. Duke pasur parasysh se kërkesa është në rregull dhe janë përmbushur kushtet ligjore, propozohet të miratohet vendim për vazhdimin e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë. Vendimi i miratuar do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb-faqen e Agjencisë dhe do t'i dorëzohet transmetuesit.

Kryetari Stefanovski shtoi se leja e re për radiotransmetim për "Radio Jehona" në përputhje me Ligjin do të jetë për periudhë prej 9 vitesh.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi vendim për vazhdimin e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë, PA1 nr. 08-

58 datë 14.2.2017, për periudhë prej 9 (nëntë) vitesh, nga data 17.1.2026 deri më 16.1.2035, me tekstin e propozuar në vendim.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele do t'i japë leje të re Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë, në përputhje me pikën 1 të këtij Konkluzioni.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë, për periudhën për të cilën vazhdohet leja, është e detyruar të punon në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Ligjin për Media, rregulloret e miratuara në bazë të ligjit, si dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara të lejes.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendim e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Kryetari Stefanovski, pas votimit të kryer, e përgëzoi "Radio Jehonën" nga Kumanova me rastin e marrjes së lejes së re dhe dëshiroi radio valë të suksesshme dhe paqësore në nëntë vitet e ardhshme.

Pika 3

Udhëheqësja mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë së SHTR "Radio VAT" SHPK Shkup. Ajo shpjegoi se transmetuesi ka dorëzuar në Agjenci njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësisë, duke kërkuar pëlqimin për tërheqjen e pronarëve ekzistues dhe për hyrjen e personit juridik Bashkësia Fetare Islame si pronar i ri. Sipas të dhënave nga Regjistri i pronarëve përfitues që udhëhiqet nga Regjistri Qendror, pronari përfitues i Bashkësisë Fetare Islame, në cilësinë e personit të autorizuar, është personi fizik Shaqir Fetai. Me qëllim për të përcaktuar nëse ndryshimi i propozuar i strukturës së pronësisë së "Radio Vat" do të krijojë përqendrim të palejuar mediatik, Agjencia siguroi të dhëna nga sistemi i shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror. Të dhënat e marra tregojnë se personi juridik Bashkësia Fetare Islame paraqitet si themelues - pronar i katër personave të tjerë juridikë, ndërsa për pjesëmarrjen e tij në dy persona të tjerë juridik nuk ka të dhëna në Regjistrin Qendror. Për më tepër, Agjencia siguroi gjendjen vijuese të personit fizik dhe pronarit përfitues Shaqir Fetai, nga i cili mund të konstatohet se ai paraqitet si pronar përfitues i Bashkësisë Fetare Islame, Shoqatës së Shërbimeve Funerale "Ep-Paxaty" SHPKNJP Shkup dhe Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup. Bazuar në analizën e kryer, u përcaktua se ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio VAT" SHPK Shkup nuk krijojnë përqendrim të palejuar mediatik në kuptim të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), përkatësisht se ndryshimi nuk është në kundërshtim me ndalesat e përcaktuara në nenet 34, 35 paragrafi 2 dhe 38 të Ligjit. Prandaj, propozohet të pranohet propozimi i paraqitur dhe të miratohet vendim që lejon ndryshim në strukturën e pronësisë së "Radio VAT", si dhe të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejon ndryshim në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio IO VAT" SHPK Shkup, me tekstin e propozuar në Vendim.

Ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive "Radio VAT" SHPK Shkup nuk krijon përqendrim të palejuar mediatik në

kuptimin e LShMAAV, përkatësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat në nenet 34, 35 paragrafi 2 ose 38 të LShMAAV.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit do ta publikojë Vendimin në ueb-faqen e Agjencisë.

Kryetari Stefanovski, pas votimit të kryer, i përgëzoi pronarët e rinj dhe u uroi suksese në punën e tyre të ardhshme.

Pika 4

Udhëheqësja mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR "Modea" SHPKNJP Sveti Nikollë, për shkak të shkeljes së nenit 53, paragrafët 4 dhe 5, në lidhje me nenin 53, paragrafët 6 dhe 19 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV). Gjithashtu sqaroi se në programin e RA "Modea" u krye monitorimi i rregullt i programit të transmetuar më 3 dhjetor 2025, gjatë të cilit u konstatua se në disa raste u transmetua komunikim komercial audio në të cilin në mënyrë të rreme u përshkrua natyra dhe karakteristikat e shërbimit të reklamuar, dhe njëkohësisht që inkurajon sjellje të dëmshme për shëndetin. Konkretisht, u transmetua reklamë që pretendon shërimin e bakterjeve, cista, urinimin gjatë natës, gurët në veshka, ankthin, traumat, problemet me shtyllën kurrizore, spondilozën, kancerin, bronkitin, diabetin, si dhe zgjidhjen e keqkuptimeve martesore dhe depresionin. Duke pasur parasysh shkeljen e konstatuar, propozohet të shqiptohet masë paralajmërim publik dhe transmetuesi të urdhërohet menjëherë, pas pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit. Ljubevska informoi se në deklaratën me shkrim të dorëzuar në Agjenci, radioja deklaroi se reklama e kontestuar ishte hequr nga programi menjëherë pas marrjes së raportit me shkrim. Gjithashtu thuhet se Sektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik, do të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përc të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e rregullt programore, nr. 10-5538/1 datë 23.12.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR "Modea" SHPKNJP Sveti Nikollë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 53, paragrafët 4 dhe 5, dhe në lidhje me nenin 53, paragrafët 6 dhe 19 të LShMAAV, sepse më 3 dhjetor 2025, në katër blloqe reklamuese u transmetua komunikim komercial audio në të cilin në mënyrë të rreme u paraqit natyra dhe karakteristikat e shërbimit të reklamuar dhe u inkurajua sjellje e dëmshme për shëndetin.

Në përputhje me pikën 12 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (teksti i pastruar) nr. 01-4241/1 datë 1.10.2025, urdhërohet që menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Sektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb- faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj SHTR "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë, për shkak të shkeljes së nenit 51, paragrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV). Ajo shpjegoi se në programin e "Radio Jehona", të transmetuar më 3 dhjetor 2025, u realizua mbikëqyrje e rregullt, gjatë së cilës u konstatua se transmetuesi nuk ka ofruar informacion që detyrimisht duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, përkatësisht: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audio, adresë të selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio, të dhënat për kontakt (numër telefoni, adresë të postës elektronike dhe/ose ueb-faqes, si dhe personin përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas), si dhe të dhëna mbi organin rregullator kompetent. Për shkak të gjendjes së konstatuar, propozohet të shqiptohet masë paralajmërim publik dhe transmetuesi urdhërohet në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit. Pas skadimit të afatit do të kryhet mbikëqyrje kontrolli. Ljubevska informoi se në materialet e paraqitura përfshihet dhe njoftimi nga "Radio Jehona", ku thuhej se kemi të bëjmë me gabim teknik të paqëllimshëm, si dhe bindjen se në të ardhmen do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përsëritjen e tij.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr. 10-5511/1 datë 23.12.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR "Radio Jehona" FM SHPKNJP Kumanovë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 51, paragrafi 1 të LShMAAV, sepse më 3 dhjetor 2025, nuk ka siguruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (teksti i pastruar) nr. 01-4241/1 datë 1.10.2025, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes së Vendimit.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Sektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 6

Të ndryshme

Këshilltarja Gordana Majnova, në kontekstin e miratimit të Ligjit për mbrojtjen nga duhani, informoi se ishte kontaktuar nga Ministria e Shëndetësisë, ku ishte njoftuar se është dërguar kërkesë për mendim drejtuar Ministrisë së Transformimit Digjital. Ajo pyeti nëse ishte e nevojshme që njëkohësisht të dërgohej kërkesë për mendim drejtuar AShMA-së, apo nëse Ministria e Transformimit Digjital do t'i paraqë shkresë drejtuar AShMA-së me kërkesë për mendim në lidhje me Ligjin.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi se dispozitat që lidhen me ndalesat e reklamimit të cigareve në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele burojnë nga një direktivë evropiane, ndërsa Ligji për mbrojtjen nga duhani aktualisht është duke u harmonizuar me një direktivë tjetër evropiane. Ajo theksoi se nuk është e nevojshme që AShMA të japë mendim, por nëse kërkohet, kjo zakonisht do të bëhet përmes ministrisë kompetente, dhe jo duke iu drejtuar drejtpërdrejt Agjencisë.

Këshilltarja Majnova deklaroi shtesë se në Propozim-ligjin për mbrojtjen nga duhani, Agjencia është renditur si organi kompetent për kryerje të mbikëqyrjes mbi zbatimin e dispozitave të caktuara ligjore. Ajo gjithashtu informoi se Ministria e Shëndetësisë ka propozuar mbajtjen e një takimi me Agjencinë në ditët në vijim, duke marrë parasysh që AShMA është përfshirë në Ligj si organ kompetent për monitorimin e zbatimit të Ligjit.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – shef kabineti, mr. Dragica Ljubevska, theksoi se nëse Agjencisë i caktohet një rol i tillë, sigurisht që do të kërkohet mendim zyrtar nga AShAMA. Ajo sqaroi se deri në këtë moment drejtuar Agjencisë nuk është dorëzuar shkresë zyrtare, por se anëtarët e Këshillit do të informohen me kohë kur të arrijë.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**